
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Data: 12/06/2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: BLERJE SETE TË URGJENCËS MJEKËSORE PËR QKUM
MARRËVESHJE KUADËR ME NJË OPERATOR EKONOMIK, KU TË GJITHA
KUSHTET JANË TË PËRCAKTUARA**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Doreza një-përdorimshe - 18424300-0

Bateri - 31440000-2

Fasho - 33141113-4

Kateterë - 33141200-2

Shiringa - 33141310-6

Qese urine - 33141615-4

Maska oksigjeni - 33157200-7

VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit total i marrëveshjes kuadër është 33,310,983.33 (tridhjetë e tre milion e treqind e dhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë tridhjetë e tre lekë pa TVSH ose 350,457.48 (treqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë pikë dyzet e dy) euro pa TVSH.

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 11.06.2026 është 95.05 (nëntëdhjetë e pesë pikë zero pesë) euro

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”. Neni 83 i LPP përcakton se “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes

tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”* dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: *“3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë :a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.*

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së fondit limit të lotit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontratës për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve për vitet ushtrimore (2023, 2024,2025) të konfirmuara nga autoritetet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 (të ndryshuar) atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në pikat 2 dhe 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “2 “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata” dhe në pikën 5 përcaktohet se: “.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitetin sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar dhe nenit 14 të Nr. 10 091, datë 5.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar përcaktohet se: “4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

Në nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar, përcaktohet se: “*Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike me interes publik; b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.*”

Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve të tre viteve të fundit financiare, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, më qëllim që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Dorëzimi i bilanceve kontabël të konfirmuar nga autoritet tatimore kërkohet për të dëshmuar se kopja e bilancit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi është kopje e njëjtë me atë të paraqitur pranë administratës tatimore.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a)** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b)** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar neni 40 pika 3 dhe 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se*

operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësinë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 40 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se:

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme cka duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve si më sipër kërkuar. Një operator ekonomik i cili ka realizuar më parë kontrata të ngjashme me objektin e prokurimit, i krijon bindjen dhe besueshmërinë te Autoritetit Kontraktor, se ai ka aftësi organizative, personelin e nevojshëm dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie të kërkuar në dokumentet e tenderit.

Furnizimet e mëparshme të ngjashme janë kërkuar në vlerën jo më pak se në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Licencë/autorizim për tregtim me shumicë të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”, i ndryshuar, i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave.

Argumentimi: Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një

kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Bazuar në nenin 40 pika 5/a përcaktohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

Ky kriter vendoset dhe në zbatim të Ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore," i ndryshuar, ku në nenin 4 pika 1 e në vijim të tij përcaktohet se: “Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. “Pajisje mjekësore” është çdo instrument, aparat, material ose mjet tjetër, i përdorshëm vetëm ose i kombinuar dhe që veprimin e synuar në ose mbi trupin e njeriut e kryen i ndihmuar nga mjete farmakologjike, imunologjike apo metabolike: a) për diagnostikimin, parandalimin, monitorimin, trajtimin ose zbutjen e sëmundjes; b) për diagnostikimin, monitorimin, trajtimin, zbutjen ose kompensimin e një dëmtimi apo të mete; c) për hetimin, zëvendësimin ose modifikimin e anatomisë apo të një procesi fiziologjik; ç) për kontrollin e ngjizjes; d) produkte të dedikuara posaçërisht për pastrimin, dezinfektimin ose sterilizimin e pajisjeve; dh) pajisjet të cilat nuk janë të destinuara për një qëllim të caktuar mjekësor si më poshtë: i) produkte të destinuara për t’u futur plotësisht ose pjesërisht në trupin e njeriut përmes mjeteve invazive kirurgjikale, me qëllim të modifikimit të anatomisë ose fiksimit të pjesëve të trupit, me përjashtim të produkteve për tatuazhe dhe piercing; ii) substancat, kombinime të substancave, ose produkte të destinuara për t’u përdorur për mbushjen e mukozës së fytyrës ose zona të tjera të lëkurës ose mukozës me anë të injeksionit subkutan, submukozë ose intradermal, duke përjashtuar ato për tatuazhe; iii) pajisjet e destinuara për t’u përdorur për të zvogëluar, hequr ose shkatërruar indin dhjamor, siç janë pajisjet për liposuction, lipolizë ose lipoplastikë; iv) rrezatimi elektromagnetik me intensitet të lartë, të tilla si: pajisje që lëshojnë rrezatim infra të 2 kuq, dritë të dukshme dhe ultra vjollcë, të destinuar për përdorim në trupin e njeriut, duke përfshirë burime koherente dhe jokoherente, spektër monokromatik dhe të gjerë, si lazer dhe pajisje të lehta me puls intens, për rishfaqjen e lëkurës, tatuazhi ose heqja e flokëve ose trajtim tjetër i lëkurës; v) pajisjet e destinuara për stimulimin e trurit që aplikojnë rryma elektrike ose fusha magnetike ose elektromagnetike që depërtojnë në kranium për të modifikuar aktivitetin neuronal në tru. 2. “Aksesori” është mjete, i cili, megjithëse nuk klasifikohet si pajisje mjekësore, është destinuar specifikisht nga prodhuesi i tij për t’u përdorur së bashku me një pajisje mjekësore, duke mundësuar që pajisja mjekësore të përdoret në përputhje me përdorimin e saj të synuar. 3. “Pajisje mjekësore e diagnostikimit in vitro” është një reagent, produkt reagenti, produkt kalibrator, material kontrolli, kit, instrument, aparat, pajisje apo sistem, që përdoret vetëm ose në kombinim, i destinuar nga prodhuesi për t’u përdorur in vitro për ekzaminimin e mostrave, përfshirë gjakun dhe indet, që rrjedhin nga trupi i njeriut, me qëllim sigurimin e informacionit: a) lidhur me një gjendje fiziologjike ose patologjike; b) lidhur me një

anomali kongjenitale; c) për të përcaktuar sigurinë dhe përshtatshmërinë me një pranues potencial; ç) për të monitoruar masat terapeutike. 4. “Pajisje për vetëtestim” është çdo pajisje e synuar nga ana e prodhuesit për t’u përdorur nga joprofesionistë në mjedisin e shtëpisë. 5. “Pajisje për vlerësimin e performancës” është çdo pajisje e synuar nga ana e prodhuesit për të kryer një ose më shumë studime vlerësuese të performancës në laboratorë për analiza mjekësore ose në mjedise të tjera të përshtatshme. 6. “Pajisje mjekësore aktive” është çdo pajisje mjekësore, veprimtaria e së cilës varet nga një burim i energjisë elektrike ose çdo burim tjetër alternativ. 7. “Pajisje mjekësore e implantueshme aktive” është çdo pajisje mjekësore aktive, e cila ka për qëllim të jetë krejtësisht apo pjesërisht e futur, nëpërmjet procedurave kirurgjike apo mjekësore, në trupin e njeriut në kavitetet natyrale dhe është e menduar të mbetet aty pas kësaj procedure. 8. “Pajisje me porosi” është çdo pajisje e prodhuar sipas përshkrimit me shkrim të një mjeku të kualifikuar, që jep nën përgjegjësinë e tij karakteristika specifike të prodhimit dhe ka për qëllim të përdoret te një pacient i veçantë. Pajisjet e prodhuara në masë, të cilat duhet të përshtaten në mënyrë që të plotësojnë kërkesat specifike të mjekut apo të ndonjë përdoruesi tjetër profesional nuk konsiderohen pajisje me porosi. 9. “Pajisje e destinuar për hetimin klinik” është çdo pajisje e destinuar për t’u përdorur nga një person i kualifikuar për të kryer hetime klinike në një mjedis të përshtatshëm njerëzor.” dhe nenit 22 të ligjit ku përcaktohet se: “1. Tregtimi me shumicë i pajisjeve mjekësore kryhet nga tregtuesit me shumicë, të cilët janë persona juridikë të licencuar për këtë veprimtari, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet. Kushtet e licencimit, dokumentet shoqëruese, afatet e vlefshmërisë dhe procedurat e shqyrtimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ministri përgjegjës për shëndetësinë është organi që shqyrton dhe merr vendimin përfundimtar për kërkesat për pajisjen me licencë për tregtimin me shumicë të pajisjeve mjekësore. Ministri përgjegjës për shëndetësinë është autoriteti përgjegjës për revokimin dhe pezullimin e kësaj licence. 2. Tregtuesi me shumicë i pajisjeve mjekësore kryen importin dhe eksportin e pajisjeve mjekësore. 3. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë i dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave listën e tregtarëve me shumicë dhe, rast pas rasti, e njofton këtë drejtori për ndryshime apo shtesa të mundshme në këtë listë”. Referuar këtyre dispozitave mallrat objekt prokurimi të kërkuara konsiderohen si pajisje mjekësore, për të cilat ligji parashikon që treguesit e këtyre mallrave duhet të pajisjen me autorizim/licence nga strukturat përgjegjëse.

Kërkesa përse i përket këtij autorizimi/licencimi synon të sigurojë një nivel të lartë mbrojtjeje të sigurisë dhe shëndetit për pacientët, përdoruesit dhe palët e treta. Për autorizimin/licencimin e tregtimit të pajisjeve mjekësore, kriteret e kualifikimit përfshijnë përputhjen me standardet e sigurisë dhe efektshmërisë të përcaktuara nga prodhuesi, si dhe respektimin e procedurave të regjistrimit dhe vlerësimit të konformitetit të pajisjeve mjekësore sipas parashikimeve ligjore. Ky kriter është një garanci për autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë pjesëmarrës e ushtrojnë aktivitetin e tyre konform legjislacionit në fuqi për pajisjet mjekësore.

3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha mallrat objekt prokurimi. Në rast se, do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet

kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në neni 40/3/ 8 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” dhe në pikën 8 përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale dhe të cilësisë nga operatori ekonomik pjesëmarrës. Autorizimi i prodhuesit/ ose distributorit të autorizuar duhet të paraqitet nga operatori ekonomik, pasi vërteton që prodhuesi/ distributor i autorizuar, autorizojnë operatorin ekonomik të tregtojë produktin e tij në Republikën së Shqipërisë. Me anë të këtij kriteri operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka të drejtat ligjore nga prodhuesi për të ofertuar mallrat e kërkuar, origjinale të prodhuara nga prodhuesi. Në rast se ofertuesi e ka marrë të drejtën për të ofertuar mallrat e kërkuar nga distributori i autorizuar nga prodhuesi atëherë, ofertuesi duhet të vërtetojë lidhjen midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Synimi i kësaj kërkesë për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit është garantimi që ofertuesi ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën me autoritetin kontraktor, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar mallrat, me garanci e suport teknik.

Nisur nga rëndësia që sigurimi në cilësi, kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme me materiale/sete mjekesore të cilat janë mallra të rëndësishëm në fushën e mjekësisë, pasi lidhen drejtpërdrejt me shërbimin ndaj shëndetit të qytetarëve, si dhe nisur nga sasia dhe vlera e fondit limit, njësia e prokurimit gjykon se, ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin dhe është në proporcion me objektin e kësaj procedure prokurimi, dhe nuk e kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi si dhe nuk e ulin konkurrencën dhe në këtë kuadër.

4.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA / deklaratë konformiteti CE ose FDA për mallrat objekt prokurimi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në pikën 1 të nenit 44, të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në nenin 79 pika 1 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet,

objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Në nenin 44 pika 1 të të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”*

Ky kriter vendoset dhe në zbatim të Ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore," i ndryshuar, ku në nenin 17 të tij përcaktohet se: *“1. Konformiteti i pajisjes mjekësore me kërkesat thelbësore konfirmohet nga lëshimi i dokumentit të konformitetit të markimit CE. 1/1. Konformiteti i pajisjes mjekësore me kërkesat thelbësore konfirmohet nga lëshimi i dokumentit të certifikimit FDA. 2. Prodhuesi i pajisjes mjekësore, për të vendosur markimin CE ose certifikimit FDA, sipas çdo klasifikimi pajisjeje, ndjek procedurën e vlerësimit të konformitetit, të përcaktuar në rregullat teknike për kërkesat thelbësore, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. 3. Markimi CE nuk është i nevojshëm për pajisjet mjekësore të destinuara për hetime klinike dhe për pajisje me porosi. 4. Ministri përgjegjës për shëndetësinë ka të drejtë, nëse është paraqitur një kërkesë e arsyetuar për këtë qëllim, të lejojë vendosjen në treg dhe përdorimin e pajisjeve mjekësore të veçanta, për të cilat nuk janë ndjekur procedurat për vlerësimin e konformitetit, të parashikuara në këtë nen, me kusht që përdorimi i këtyre pajisjeve të jetë absolutisht i nevojshëm për mbrojtjen e shëndetit publik.”*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike. Certifikatat e konformitetit CE (ose deklarata e konformitetit CE nëse është rasti) ose FDA approval janë dokumente të rëndësishme që vërtetojnë përputhjen e produkteve me standardet e sigurisë dhe cilësisë. Theksohet se mallrat objekt prokurimi kanë si destinacion QKUM, dhe duke vijuar arsyetimin për rëndësinë e këtij shërbimi për furnizimin me pajisje mjekësore, është e domosdoshme që furnizimet të jenë cilësore dhe konform rregullave të parashikuara nga aktet e BE (për konformitetin CE) ose të Shteteve të Bashkuara (Për aprovimin FDA).

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedë teknike/katalog teknik nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, ku të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara. Në katalog/skedë duhet të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mallit të ofruar, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për*

të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknike;”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Nisur nga lloji i mallrat që kërkohet, të cilat janë të rëndësishme për punën e QKUM, është e nevojshme që autoriteti kontraktor të sigurohet për mallrat që i ofrohen nga operatorët ekonomik pjesmarrës të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve si katalog/ skedë teknike nga prodhuesi i mallit. Gjithashtu katalogët/skedarat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

6.Operatori ekonomik duhet të paraqese certifikimin ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit të cilësisë" ose ISO 13485:2016 "Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore" ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

7.Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë për certifikimin ISO 13485:2016 "Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore" ose ekuivalent, të prodhuesit, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e çertifikatës ISO 13485:2016 "Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore" ose ekuivalent të prodhuesit, sipas deklaramit të bërë.

Argumentimi: Kërkesat 6 dhe 7 te mësipërme janë vendosur në përputhje me nenin 79 "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatatë të lëshuara nga një organ i

vlerësimin të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në pikën 1 të nenit 44 "Kërkesat e cilësisë "të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: "1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimin të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit". Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

ISO 13485:2016 është një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për sistemet e menaxhimit të cilësisë për pajisjet mjekësore. Ky standard është i nevojshëm për të siguruar siguri dhe efektivitetin të produkteve, duke përmbushur kërkesat rregullatore dhe duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë. Një ndër aspektet kryesore të ISO 13485:2016 përfshin dhe Menaxhimin e riskut: Fokus në identifikimin dhe menaxhimin e risqeve që lidhen me sigurinë dhe performancën e pajisjeve mjekësore. Përputhshmëria rregullatore: Sigurimi që pajisjet mjekësore përputhen me kërkesat ligjore dhe rregullatore. Kontrolli i furnitorëve: Kërkesa për vlerësimin dhe monitorimin e furnitorëve për të siguruar cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të tyre.

8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt me numër rendor si më poshtë vijojnë :1,3,4,7,8,10,11,12,13,14,15,17,18,19,21,28,34,35,38,40,41,42,43,46,47,48,49,50,51,53,54,56,57,58,59,62,63,65,66,68,69,71. Mosta duhet të ketë etiketën sipas prodhuesit.

-Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr "Reshit Çollaku", Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar ku përcaktohet se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës." dhe pikën 6/a, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: "6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si

informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”.

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit. Materialet/setet e urgjencës mjekësore janë mallra që përdoren drejtëpërdrejtë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore kundrejt pacientëve që trajtohen në QKUM. Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për disa nga artikujt objekt prokurimi, duke marrë në konsideratë sasinë dhe rëndësinë e tyre si dhe duke marrë parasysh që një pjesë e konsiderueshme e karakteristikave teknike të këtyre artikujve nuk mund të verifikohen plotësisht vetëm nëpërmjet dokumentacionit teknik, katalogëve, deklaratave të konformitetit apo certifikatave të prodhuesit. Mostra përbën mjetin e vetëm objektiv për të verifikuar elementët fizikë dhe funksionalë të produkteve objekt prokurimi. Kërkesa për paraqitjen e mostrave vlerësohet si e përshtatshme dhe proporcionale në raport me objektin dhe natyrën e procedurës së prokurimit.

Për këtë arsye, njësia e prokurimit vlerëson se kërkesa për mostra respekton parimin e proporcionalitetit, pasi është e lidhur ngushtë me qëllimin që synon të arrijë, nuk tejkalon masën e nevojshme për realizimin e këtij qëllimi dhe garanton një proces vlerësimi sa më objektiv, transparent dhe të besueshëm.

9. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për të gjitha artikujt e kërkuara, në formë tabele, ku të plotësohet:

Emërtimi i artikullit	Emri, Adresa, Website Kompanisë Prodhuese ose Distributorit të Autorizuar	Vendi i origjines	NR. Faqes Katallogut/skedës teknike të produktit	NR. Identifikues i Produktit (kodi) sipas Katallogut/skedës teknike	Shënime nëse është rasti

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë

kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”. Ne kete kontekst eshte kerkuar dhe oferta teknike në formë deklarative, me ane te se ciles do te behet i mundur verifikimi me i sakte i artikujve te ofertuar, origjina, konformiteti me dokumentacionin mbeshtetes te paraqitur nga ofertuesi. Duke marrë shkas nga kompleksiteti i artikujve objekt prokurimi, gjykohet e nevojshme që gjatë fazës së vlerësimit komisioni i vlerësimit të ofertave të njihet me ofertën teknike, për të bërë të mundur një vlerësim sa më eficient dhe sa më të mirëorientuar.

10.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, ku të deklarojë se afati i garancisë së mallrave objekt prokurimi, do të jetë sipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike, në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

***Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se mer përsipër periudhën e garancisë për mallrat e prokuruar ipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike, në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që mallrat objekt prokurimi janë në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi i ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimi ose riparimi i tyre pa pagesë.*

11.Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi ne destinacionin e përcaktuar në shtojcën 7 te DT “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”.

***Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të sigurojnë transportin e mallrave objekt prokurimi ne adresen e Autoritetit Kontraktor Perfitues. Kjo i jep siguri Autoritetit Kontraktor Perfitues që operatori ekonomik do të realizojë me sukses kontratën.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues “Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore”, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet teknike janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues "Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore", si më poshtë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1. AGE DEKOMPRESUESE PNX



- Age dekompresuese per pneumo toraksin tensiv ne rastet e traumave paraspitalore.
- Madhesia 14G e lehte ne perdorim sterile,1 perdorim.

2. AMBU

(Njësi e frymëmarrjes manuale artificiale)



- Të përbëhet nga material shumë rezistent silikoni dhe polisulfonat, që garanton qëndrueshmëri, transparent
- Valvula transparente me lidhës të kthyeshëm
- Të ketë rezervuar
- Lidhje vetëbllokuese
- Një nga përdorimet kryesore të një qese Ambu është reanimimi në situata emergjente, siç është arresti kardiak. Mund të përdoret gjithashtu për të ofruar mbështetje të frymëmarrjes për pacientët që nuk janë në gjendje të marrin frymë vetë, përkohësisht ose afatgjatë.

3. IMOBILIZUES I SHTYLLËS KURRIZORE (KOSH)



- Përdoret në imobilizimin dhe transportin në distanca për emergjencat traumatike në territor, në zonat malore, kanione, shpella dhe në ujë.
- Përbehet nga material polietileni me doreza mbajtëse dhe rripa fiksues. Përdoret për transportin e pacientit në mjedis jashtë spitalit dhe në distanca të largëta nga autoambulanca ose helikopteri
- Të jetë e përbër nga material polietileni me densitet të lartë me kornizë alumini dhe e kompletuar me dyshek poliuretani.
 - Përmasat: jo më pak se 190x 60 cm
 - Pesha: jo më shumë se 15 kg
 - Ngarkesa maksimale: jo më pak se 180 kg

Përdoret për transportin e pacientit në mjedis jashtë spitalit dhe në distanca të largëta nga autoambulanca ose helikopteri.

4. BATERI DEFIBRILATORI TË PËRPUTHSHME ME DEFIBRILATOR SEMI AUTOMATK (AED) RESCUE LIFE SAM (OSE EKVIVALENTE)

Për defibrilator AED Rescue Life Sam, e përbërë nga Lithium, njëpërdorimshe, me kohëzgjatje minimum 200 goditje, me garanci minimumi 2 vjet.

Pjese perberëse e AED.

5. BATERI DEFIBRILATORI TË PËRPUTHSHME ME MONITOR DEFIBRILATOR PRIMEDIC (OSE EKVIVALENTE)

Për monitor-defibrilator Primedic e përbërë nga lithium, e karikueshme, me garanci minimumi 2 vjecare.

Pjese perberëse e defimonitorit per matjen e parametrave ose defibrilimit

6. BATERI DEFIBRILATORI TË PËRPUTHSHME ME MONITOR DEFIBRILATOR RESCUE LIFE (OSE EKVIVALENTE)

Për monitor-defibrilator Rescue Life, e përbërë nga lithium, e karikueshme, me garanci minimumi 2 vjecare.

7. BLOKUES KOKE



Projektuar për të siguruar imobilizim të shkëlqyeshëm të kokës për pacientët e traumatizuar që duhet të transportohen me një imobilizues të shtyllës kurrizore. Mbështetësja bazë e kokës për ne imobilizimin e shtyllës kurrizore, e bërë nga shkumë me densitet të lartë me veshje kundër ujit. Ai lejon një bllokim të shpejtë dhe të sigurt të kokës së personit të traumatizuar.

Ky komplet përbëhet nga:

- Dy imobilizues koke në formë trapezoidi, nga shkumë e zgjeruar me densitet të lartë, e mbuluar me material vinil, i papërshkueshëm nga uji, për të shmangur thithjen e lëngjeve organike. Një bazë e mbushur, e mbuluar me material vinili të papërshkueshëm nga uji, e pajisur me rripa me sythe plastike për t'u ngjitur në lloje të ndryshme të dërrasave të shtyllës kurrizore dhe velcro, për ngjitjen e imobilizuesve të kokës
 - Dy rripa fiksues imobilizimi për kokën, të mbuluara në Material vinyl, i papërshkueshëm nga uji, i pajisur me Velcro në skajet për fiksion të shpejtë

Imobilizuesit e kokës janë gjithashtu të pajisur me një vrimë anësore për të lejuar inspektimin e veshit, duke ju lejuar të monitoroni çdo otoragji dhe të komunikoni lehtësisht me pacientin.

8. CANTA E AUTOAMBULANCËS, ME SETET E CANTAVE TË VOGLA



- Duhet të jetë multifunksionale.
- Me permasa jo me pak se 60x20 cm.
- Me qepje dhe me ngjitje.
- Me ndarje të brendshme, 5 canta te vogla.
- Të jetë me zinxhirë, që çmontohet në pjesë të ndryshme
- Të ketë xhepa anesore me zinxhire.
- Komode në pjesën e shpinës dhe me rripat me mbushje me sfungjer, të rregullueshëm për gjatësinë e trupit të personelit.
- Në pjesën e brendshme ku vendosen cantat e vogla të ketë velkro për fiksimin e tyre.
- Të jetë e përshtatshme për vendosjen e seteve të ndryshme(infuzioni, mjekimi, intubimi, ventilim, canta e parametrave).
- Të jetë e përbërë nga material shumë rezistent me kapacitet të lartë mbajtës dhe me strisho fosforeshente.
- Një cantë e madhe të ketë në përbërje të saj një set cantash të vogla (të përbërë nga 5 canta të vogla)
- Çantat i mundësojnë ekipit tonë të urgjences të marrë gjate nderhyrjes te pacientit pajisjet e mjetet, medikamentet e duhura per trajtimin e pacienti në urgjencën para spitalore, duke i dhënë atyre mundësinë më të mirë për të mbijetuar.

Set i vogël cantash:



- Të jenë me ngjyra të ndryshme identifikuese për çdo set.
- Materiali i jashtëm te jete nejlon, kundër gërvishtjeve dhe që lahet.
- Materiali i brendshem: nejlon, elastik PVC.
- Mbyllja me zinxhir.
- Xhepa të jashtëm transparente prej PVC.

- Me ngjitje nga mbrapa me velkro për fiksime të cantës së madhe dhe përmasa të përshtatshme me çantën e madhe të autoambulancës.

Çanta e intubimit



- 5 ndarje vertikale
- 5 xhepa me rrjetë
- 1 xhep i brendshëm transparent me mbyllje me zinxhir
- 2 xhepa të mëdha vertikale
- 1 ndarëse e mbushur

- Çantë për setin e mjekimit



- Çantë për setin e ventilimit



- Çantë për setin e infuzionit



- Canta e parametrave jetësorë (për mbajtjen e sfigomanometër, stetoskop, termometër, aparat glicemie, pulsoksimetër)

9. CARCAFË NJËPËRDORIMËSH



- Të jetë e përbërë nga material TNT
- Te jete me permasa brenda parametrave 140x240 cm
- Të jetë njëpërdorimshe
- Perdoren per cdo pacient gjate transportit me autoambulanc

10. DOREZA NJËPËRDORIMSHE



- Të përbëra nga 100 % nitril, me rezistencë të lartë ndaj performimit dhe materialeve të ndryshme kimike. Material termoelastik që I përshtatet me lehtësi dorës.
- Pa pluhur dhe që nuk shkaktojnë reaksione alergjike kutane
- Të jenë me përmasa të ndryshme në sasi të barabartë: 7.5-8.5 (për secilën përmasë sasia e barabartë)
- Perdoren ne cdo kontakt gjate nderhyrjes te pacienti per mbrojtjen e personelit shendetesor

11. DOREZA, STERILE

Perdoren ne egzaminime ose procedura si kateterizimi vezikal etj



- Madhësia: 7-8-9 (për secilën përmasë sasia e barabartë)
- Përbërja me lateks, pa pluhur me ngjyra natyrale.
- Veshje polimer sintetike, forma anatomike e shënuar (L / R) me gishta të lakuar, të jenë të sterilizuara

12. DOREZË LARINGOSKOPI



- Të jetë e përbërë nga metal inoxi i kromuar i përshtatshme për mbajtjen e baterisë C ose ekuivalent, që shërben për vizualizim të rrugëve të frymëmarrjes.
- Përmasat dhe pesha duhet të mundësojnë një përdorim optimal edhe në intubimet më delikate.
- Përdoret në rastet e intubimit endotrakeal në arrestin kardio- respirator

13. FASHO ADEZIVE 10X10



- Material adeziv për ngjitime të shpejta
- Të ketë përmasa: 10mx10 cm
- Ngjites hipoalergjike e indikuar për fiksimin e tubave, sondave, kateterëve, instrumenteve matëse dhe instrumenteve të ndryshme.

14. FASHO AUTOADEZIVE 10X4.5



- Material autoadeziv për imobilizim të shpejtë
- Të ketë përmasa: jo më pak se 10 cmx 4.5m
- Përdoret në rastet traumatike për tamponim ose mjekimet e nevojshme, vetëngjitet dhe puthitet mirë dhe në plagët e kokës

15. FONENDOSKOP



- Të përbëhet nga membrane që dedektojnë dhe amplifikojnë zhurmat kardiake dhe ato respiratore.
- Koka e përbërë prej inoksi që të dedektojë dhe tingujt me frekuencë të ulur.

16. GARZA PAMBUKU



- Jo sterile, me pako, me përmasa 10cmx10cm, pesha 1 kg pakoja
- Garza per mjekim ndalim hemoragjie ne pacientet traumatik ne ambientet paraspitalore

17. GËRSHËRË TË VOGLA



- Gërshërë të vogla metalike me doreza të plastifikuara
- me gjatësi jo më pak se 14 cm me majë të rrumbullakosur për të parandaluar dëmtimin e strukturave indore gjatë përdorimit.
- Përdoret për prerjen e bendeve leucoplast ose veshje të pacientit duke mos i shkaktuar dëmtim

18. GLUKOMETËR



- Me sistem për matjen e sasisë së glukozës në gjak
- Të masë sasinë e glukozës në gjak, duke e nxjerrë atë nga shirita (artikulli 72 më poshtë) në të cilën është hedhur një pikë e gjakut kapilar.
- Të jetë i pajisur me cantë mbajtëse.
- Perdoret për matjen e nivelit të sheqerit në gjakun kapilar si një nga elementet e vleresimit të parametrave të pacientit

19. IMOBILIZUES BACINI (PELVIK)



- Është disapërdorimeshe në formë rrethore e cila bllokun legenin/pelvisin në mënyrë simetrike. Ajo ndalon hemoragjinë e legenit/perlvisit kur ka fraktura të tij në trauma. Bllokohet nëpërmjet një sistemi me rrip të fortë që kalon nëpërmjet një tokëze/unaze, që lejon përshtatjen e mbylljes me ngjitje me velkro, sipas diametrit të legenit/perlvisit të pacientit.
- Radio transparent për radiologjinë, material i padeformueshëm, mund të dezinfektohet dhe dekontaminohet për shumë përdorime, rripi të jetë i përthyeshëm dhe elastik.
- Të jetë i përshtatshëm për mosha të ndryshme

20. IMOBILIZUES KOLONE ALUMINI



- Imobilizuesi i luget është i ndarë e ndare në 2 pjesë për transportin e pacientit
- Të jetë e përbërë nga material alumini me madhësi të ndryshueshme
- Të jetë e pajisur me rripat lidhës dhe dorëza transporti
- Të jetë e palosshme për të kursyer hapësirën

- Te kete gjatesi te ndryshueshme ne diapazonin 160-200 cm
- Te kete gjeresi 40-44 cm
- Pjese e setit te traumes per imobilizimin e pacientit traumatic ne terren ose transportin nga barrela ne shtrat, mund të vendoset poshtë pacientit pa pasur nevojë ta lëvizë atë, e krijuar për të imobilizuar më së miri pacientin gjatë transportit

21. KABËLL ECG 10 KANALE TË PËRPUTHSHME ME MONITOR DEFIBRILATOR RESCUE LIFE(OSE EKVIVALENTE)

- Të jetë e perputhshme me Defibrilator Rescue Life, e përbërë nga fibra optike.

22. KABËLL ECG 10 KANALE TË PËRPUTHSHME ME DEFIBRILATOR PRIMEDIC(OSE EKVIVALENTE)

Të jetë e perputhshme me Defibrilator Primedic, e përbërë nga fibra optike.

23. KABËLL SPO2 TË PËRPUTHSHME ME MONITOR DEFIBRILATOR PRIMEDIC(OSE EKVIVALENTE)

- Të jetë i perputhshëm me Defibrilator Primedic.
- Pjese e defi monitorit qe sherben per matjen e oksigjenit kapilar te pacienti dhe pulsit.

24. KABËLL SPO2 TË PËRPUTHSHME ME DEFIBRILATOR RESCUE LIFE(OSE EKVIVALENTE)

- Të jetë i perputhshëm me Defibrilator Rescue Life.
- Pjese e defi monitorit qe sherben per matjen e oksigjenit kapilar te pacienti dhe pulsit.

25. KABËLL + MANSHET (NIBP) TË PËRPUTHSHME ME MONITOR DEFIBRILATOR PRIMEDIC(OSE EKVIVALENTE)

- Të jenë të perputhshme me Defibrilator Primedic. Kablli lidhet me manshetin nëpërmjet një valvule me mekanizëm femër-mashkull, mansheta të mbyllet me velkro me ngjitje. Pjese e defimonitorit qe sherben per matjen e presionit arterial te pacienti. E përshtatshme për adult.

26. KABËLL + MANSHET (NIBP) TË PËRPUTHSHME ME MONITOR DEFIBRILATOR RESCUE LIFE(OSE EKVIVALENTE)

- Të jenë të perputhshme me Defibrilator Rescue Life. Kablli lidhet me manshetin nëpërmjet një valvule me mekanizëm femër-mashkull, mansheta të mbyllet me velkro

me ngjitje. Pjese e defimonitorit qe sherben per matjen e presionit arterial te pacienti.
E përshtatshme për adult.

27. KANJULË NAZALE PËR OKSIGJENIM



- Gjatësia e tubit jo më pak se 1.6 m
- Tubi të jetë fleksibël dhe rezistent ndaj deformimeve me PVC mjekësor
 - Kanjula nazale që përshtatet lehtë hapësirave nazale, prej PVC dhe biokompatibël
 - Pjesa fundore me përmasa standarte, e përshtatshme me të gjithë rakordet e bombolave të oksigjenit, me PVC mjekësor
- Rakord me dy dalje paralele të O2: në PVC rigide, transparente
- Përdoret për administrim të oksigjenit në patologjitë e indikuara

28. KANJULE NAZOFARINGEALE



- Kanjule e harkuar për mbajtjen hapur të rrugëve të frymarrjes nazofaringeale
- Vendoset në kavitetin nazofaringeal
- Diametrat 3 madhësi të ndryshme 7,8,9 (në sasi të barabartë secila masë)
- Pajisje që inserohet në kavitetin nazal dhe shërben për ruajtjen e rrugëve të frymarrjes në një pacient jo koshient
- Materiali: PVC (pa lateks)

29. KANJULË OROFARINGEALE



- Kit me përmasa adulte 4,5,6 (në sasi të barabartë për secilën masë)
- Dizajn anatomik
- Fund i butë dhe i rrumbullakosur që parandalon dëmtimin e indeve
- Fleksibile duke mos demtuar dhembet gjate kafshimit dhe pengon mbylljen e rrugeve ajrore.
- Garanton akses për kateter aspirimi
- Me ngjyra të kodifikuara sipas përmasave
- Me material silikoni transparent
- Të jetë e pasjitur me mbajtëse.
- Pajisje që inserohet në kavitetin oral dhe shërben për ruajtjen e rrugeve të frymarjes në një pacient jo koshient

30. KANJULA VENOZE 20G/22G



- Me përmasa 20 G dhe 22G, të identifikuara me ngjyra (në sasi të barabartë për secilën masë)
- Të jetë me dy rrugë soministrimi medikamentesh
- Të jetë sterile
- Shërben gjate nderhyrjeve për aksesin venoz të pacientit.

31. KATETER URINAR FOOLEY 14,16,18



- Të jetë model foley.
- Të jetë sterile dhe njëpërdorimshe në masat 14, 16,18 (në sasi të barabartë secila masë)
- Shërben për eliminimin e urines të pacientit me probleme akute ose kronike të patologjive të indikuara.

32. KLEMA UMBILIKALE



- I pershtatshem per blokimin e kordonit umbelikal ,1 perdorim, steril,Perdoret ne rastet e lindjeve ne banes ,gjate transportit me autoambulancë apo ambjente jasht spitali.

33. LAK HEMOSTATIK



- Të jetë modeli tubular e përbërë nga material latex
- Te këtë gjatesi min 30 cm. Perdoret per identifikimin e sistemit venoz kur duhet te aksesojm per nderhyrje me medikamente.
- Të jetë modeli manual shumeperdorimesh

34. LAMA



- Të këtë formë të lakuar e cila mundëson rrëshqitjen në nivel te valekulave dhe mbajtjen hapur te rrugeve te frymëmarrëjes duke shtypur gjuhën, me masa te ndryshme
- Te jete në masa adulte
- Pjese perberse me permasa te ndryshme sipas anatomis se pacientit per itubim ne rastet e indikuara

35. LANCET (Age për gjak kapilar)



- Pajisje projektuar për marrjen e gjakut kapilar.
- Maja shumë e mprehtë që lejon depërtim të lehtë në mollzat e gishtave.

- Shërben për të shmangur kontaktin aksidental me mostrën e gjakut për operatorët shëndetësor.
- Të jetë sterile.
- Mjet i mpreht për shpimin e gishtit gjatë matjes së glicemisë.

36. LETËR ECG TË PËRPUTHSHME ME MONITOR DEFIBRILATOR PRIMEDIC(OSE EKVIVALENTE)

- Të jetë e palosshme me 100 flete dhe e përputhshme për defibrilator Primedic, me përmasa 58 mm x 28 m.
- Përdoret për printimin e elektokardiogrames 12 lidhje ose të dhënave të parametrave jetësor të pacienti në monitorim.

37. LETËR ECG TË PËRPUTHSHME ME DEFIBRILATOR RESCUE LIFE(OSE EKVIVALENTE)

- Të jetë e përputhshme për defimonitor Rescue Life, me përmasa 58 mm x 30m.
- Përdoret për printimin e elektokardiogrames 12 lidhje ose të dhënave të parametrave jetësor të pacienti në monitorim.

38. MAGIL FORCEPS

Përbërje metalike, e përshtatshme për adultë dhe pediatrike (5 pediatrike dhe 15 adulte)



- Pincë që përdoret për heqjen e truave të huaj në rrugët e frymëmarrjes, drejtimin e tubit endotrakeal, si dhe ndihmon në vendosjen e tubit nazogastrik.

39. MASKA LARINGEALE NJËPËRDORIMSHME



- Rrugë alternative e mbrojtjes së rrugëve të frymëmarrjes dhe ventilimit efikas të pacientëve në arrest respirator ose kardio-respirator.

- Perdoret si një mjet i shpejtë për sigurimin e rrugëve respiratore në patologjitë jetë kercënuese
- Maska laringeale (3 masa adulte)
- 1 përdorimshme
- E dizajnuar për të bërë kalimin e ajrit pa u penguar nga epigliti .
- Jastek ajri i butë që shërben për të bllokuar ezofagun dhe kalimin e ajrit në trake
- I lehtë për tu vendosur në rastet emergjente

40. MASKË OKSIGJENI ME REZERVUAR



- Maskë për oksigjeno-terapi me përqëndrim të mesëm, e butë, dhe me tub lidhës jo më pak se 2 m, transparente.
- Me llastik për tu fiksuar në kokën e pacientit

41. MASKË SILIKONI PËR AMBU



- Të jetë e pajisur me jastëkë ajri që të garantojë përshtatshmërinë maksimale me fytyrën e pacientit
- Maska e përshtatshme sipas formës anatomike të pacientit për rastet e frymarjes artificiale në arres kardio respirator ose patologjitë që e indikojnë.

42. MBULESË IZOTERMIKE ALUMINI



Mbulesa izotermike (e njohur edhe si batanije termike ose batanije e emergjencës) është një pajisje e thjeshtë, por shumë efektive në ndihmën e parë dhe në kujdesin emergjent për ruajtjen e temperaturës trupore të pacientit në situata kritike.

Mbulesa izotermike përdoret për:

1. Parandalimin e hipotermisë (ulja e temperaturës trupore).
2. Parandalimin e hipertermisë (rritja e temperaturës trupore).
3. Mbrojtje nga faktorët e jashtëm: era, shi, diell, lagështirë.
4. Situata emergjente: trauma, ekspozim ndaj të ftohtit apo të nxehtit, aksidente automobilistike, hipotermi tek të mbijetuarit në mjedise të ftohta apo pas përmytjeve, etj.
5. Izolim termik gjatë lindjes në ambient jo të përshtatshëm.

Materiali Poliester i veshur me alumini

Pesha 40-60 gram

Madhësia e hapur jo më pak se ~ 180 x 140 cm


Ngjyre Argjendi jashtë, ari brenda. Argjendi reflekton nxehtësinë jashtë, përdoret për pacientë me goditje nga nxehtësia (hipertermi).

Ari jashtë, argjendi brenda Argjendi reflekton nxehtësinë drejt trupit, përdoret për pacientë me hipotermi, për ta mbajtur trupin të ngrohtë.

Në praktikën paraspitalore dhe të urgjencës, mbulesa izotermike është pjesë standarde e

cdo seti të ndihmës së parë, ambulancës dhe çantave të ndërhyrjes.

43. MUSHAMA TELO



-Me 6 ose 8 doreza.

- Transferimi nga barela në shtrat;

- Transporti në barelë.

Materiali i papërshkueshëm nga uji - mund të dezinfektohet shpejt.

Përmasat e vogla e bëjnë atë perfekt për ruajtje në hapësira të vogla.

Karakteristikat kryesore:

- Material rezistent ndaj ujit.

- Kapaciteti i ngarkesës: jo më pak se 120 kg.

- Përdoret për transporte të pacientit jo traumatik në hapësira të ngushta ose për transferim drejt bareles ose shtratit.

44. NGJITËSE PËR ELEKTRODA

- Elektrodat EKG të jenë të përshtatshme për regjistrimin e elektrokardiogramave duke i aplikuar ato drejtpërdrejt në sipërfaqen e lëkurës. Sensori Ag/AgCl siguron një gjurmë të qëndrueshme dhe të besueshme të EKG-së.
- Te jene me diameter 50-55mm me permbajtje Ag/agCl Xhel me klikim
- Universale

45. PAKETË DIZINFEKTUESE

- Me dezinfektantë për plagë. Cdo pakete duhet te permbaje:
- Betadinë, 1 litër
- Uje i oksigjenuar, 1 litër
- Alkohool, 1 litër
- Per dezifektim te zones anatomike apo mjeteve te nderhyrjes te pacienti

46. PIASTRA ADULTE AED TË PËRPUTHSHME ME MONITOR DEFIBRILATOR PRIMEDIC(OSE EKVIVALENTE)

- Të kryejne funksionin e defibrilimit nje perdorimshe adezive dhe me diagrame per vendosje te qarte
- Të jetë e përputhshme per defimonitor Evo
- Të jetë per perdorim adult
- Pjastra 1 perdorim per percjelljen e rrymes elektrike drejt muskulit kardiak ne nje arrest ose si pacemaker ose ne konvertime te aritmive te ndryshme

47. PIASTRA ADULTE AED TË PËRPUTHSHME ME DEFIBRILATOR RESCUE LIFE(OSE EKVIVALENTE)

- Të kryejne funksionin e defibrilimit nje perdorimshe adezive dhe me diagrame per vendosje te qarte
- Të jetë per perdorim adult
- Të jetë e përputhshme per Rescue Life
- Pjastra 1 perdorim per percjelljen e rrymes elektrik drejt muskulit kardiak ne nje arrest ose si pacemaker ose ne konvertime te aritmive te ndryshme

48. PIASTRA PEDIATRIKE AED TË PËRPUTHSHME ME MONITOR DEFIBRILATOR RESCUE LIFE(OSE EKVIVALENTE)

- Të kryejne funksionin e defibrilimit nje përdorimshme adezive dhe me diagrame per vendosje te qarte
- Të jetë per perdorim pediatric
- Të jetë e përputhshme per Rescue SAM Aed

- Pjastra 1 perdorim per percjelljen e korendit elektrik drejt muskulit kardiak ne nje arrest ose si pacemaker ose ne konvertime te aritmive te ndryshme

49. PULSOKSIMETËR



- I lehtë, kompakt, me gërma te medha dixhitale.
- Të pranojë sensorë te ripërdorshëm dhe konsumi
- Të jetë i pajisur me cantë mbajtëse dhe varëse për qafën.
- Perdoret per matjen e nivelit te oksigjenit kapilar si nje nga parametrat jetesorë.

50. QAFORE (Bllokues i kolonës cervikale)



- Të jetë me përmasat jo më pak se 30x30 cm
- Duhet të garantojë gjatë lëvizjes së të dëmtuarit një linearizim sipas aksit anatomik dhe shtrirje të sigurt të vertebrave cervikale .
- Duhet të sigurojë një kontroll të mirë të lëvizjeve aksiale dhe përkuljeve laterale të kolonës
- Struktura themelore të jetë e realizuar me material polietilieni me densitet të ulët, që siguron pastrim të lehtë.
- Të jetë fleksibël për të përmirësuar aplikimin, dhe e ngurtë për të përmirësuar imobilizimin.
- Të ketë një hapje të përparme për të lehtësuar aksesin e trakeotomisë.
- Mund të jetë e përbërë nga një pjesë e vetme ose dy pjesë që lidhen me velkro me ngjitje.
- Fiksimi bëhet me velkro me ngjitje.
- Të jetë në 3 masa S,M, L (në sasi të barabartë për secilën masë)
- Perdoret per imobilizimin e kolones cervikale ne cdo raste trauma ose jo ku kemi dyshime demtimi

51. QESE URINE



- Kapaciteti 1500 ml, gjatësia e tubit jo më pak se 90 cm.
- Perdoret per grumbullimin dhe matjen e diurezes.

52. SET I VOGËL CANTASH (set 5 copë)



- Të jenë me ngjyra të ndryshme identifikuese për çdo set.
- Materiali i jashtëm te jete nejlun, kundër gërvishtjeve dhe që lahet.
- Materiali i brendshem: nejlun, elastik PVC.
- Mbyllja me zinxhir.
- Xhepa të jashtëm transparente prej PVC.
- Me ngjitje nga mbrapa me velkro për fiksime te canta e madhe dhe përmasa të përshtatshme me çantën e madhe të autoambulancës.

- Çanta e intubimit



- 5 ndarje vertikale
- 5 xhepa me rrjetë
- 1 xhep i brendshëm transparent me mbyllje me zinxhir
- 2 xhepa të mëdha vertikale
- 1 ndarëse e mbushur

- Çantë per setin e mjekimit



- Çantë për setin e ventilimit



- Çantë për setin e infuzionit



- Canta e parametrave jetësorë (për mbajtjen e sfigomanometër, stetoskop, termometër, aparat glicemie, pulsoksimetër)

53. SET IMOBILIZIMI GJYMTYRËTSH SPLINTER KIT ME 5 PJESË, ME CANTË MBAJTËSE



- Sistem për imobilizimin e gjymtyrëve në rastet e frakturave të gjymtyrëve të sipërm dhe të poshtëm, te të rriturit dhe fëmijët.
- Mbyllja me shirita me ngjitje.
- Bordurat të jenë me qepje ose ngjitje që sigurojnë qëndrueshmëri.
- Materiali Neopren (familja e gomës), Alumin, i veshur në pjesën e brendshme dhe të jashtme me nylon laminat.
- Material shumë rezistent, 100% kundër lëgështirës, i cili është i lehtë për t'u pastruar.
- I përbërë nga 5 pjesë:

- Për imobilizimin e frakturave të pulsit
- Për imobilizimin e parakrahut të të rriturit dhe të gjymtyrëve të poshtëm të fëmijës
- Për imobilizimin e kavigjës, bërrylit ose si bllokues krahu gjatë infuzionit venoz
- Për imobilizimin e gjymtyrëve të sipërm të të rriturit ose të gjymtyrëve të poshtëm të fëmijëve
- Për imobilizimin e gjymtyrëve të poshtëm të të rriturit.
- E pajisur me çantë për vendosjen e setit.

54. SET SHIRINGE INTRAKOCKORE PËR URGJENCËN



Përdorimi: Vendosja e rrugës intra-kockore për administrim të lëngjeve, medikamenteve dhe transfuzioneve në situata emergjente

I përshtatshëm për pajisje EZ-IO ose sisteme ekuivalente.

PËRBËRJA E SETIT :

- Age IO (kanulë intraosseoze) 15G ose 18G; me gjatësi të ndryshme sipas moshës dhe zonës (veç për pediatri, adult ose universal).
- Kateter me port Luer-Lock Përdorim standard për lidhje me sistemet IV.
- Fiksues stabilizues (stabilizing device) Dispozitiv ngjitës ose mbajtës plastik që mban age-n të palëvizshme pas vendosjes.
- Tub lidhës për infuzion Lidh kateterin IO me sistemin e infuzionit.

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR AGET:

Gjatësia Diametri (Gauge) përdorimi rekomanduar:

- 15 mm 15G/18G Fëmijë (pediatrik) ose pacient me trup të hollë
- 25 mm 15G Adult standard
- 45 mm 15G Adult obez ose vendosje tibiale/humerale në pacientë të mëdhenj

55. SET IMOBILIZIMI KOLLONE



- Të përmbushë kërkesat ergonomike sipas standarteve ndërkombëtare
- Të jetë e përbërë nga materiale të përshtatshme dhe dhe radiotransparent.
- kapaciteti mbajtes jo më pak se 150 kg
- Të jetë e përshtatshme për adultët dhe fëmijët
- Të ketë hapësira anësore për fiksimin e rripave me velkro ose tokëza për imobilizimin e pacientit
- Të vendosen me lehtësi mbajtëset e kokës
- Të ketë rripa me velkro për bllokimin e kokës
- Përdoret në imobilizimin e një pacienti traumatik ku kemi dyshime për dëmtim të shtyllës kurrizore

56. SFIGMOMANOMETËR



- Sfigmomanometër klasik me manshetë pëlhure me mbyllje velcro
- Manometër i përshtatshëm (60 mm) për lexime të lehta.
- Shkallë 0-300 mmHg, graduar çdo 2 mmHg.
- Përdoret për matjen e vlerave të presionit të gjakut, si një nga parametrat jetësor për vlerësimin e pacientit

57. SHIRNIGA 10 ML PLUS AGE 21 G



- Të jetë e përbërë nga 3 pjesë
- Te jete e pajisur me agen
- Të jetë sterile dhe njëpërdorimshe, 20 cc
- Për aplikimin e medikamenteve sipas dozave dhe rruges së administrimit iv, im etj

58. SHIRINGA 20 ML PLUS AGE 21 G



- Të jetë e përbërë nga 3 pjese
- Te jete e pajisur me agen
- Të jetë sterile dhe njëpërdorimshe, 10 cc
- Per aplikimin e medikamenteve sipas dozave dhe rruges se administrimit iv,im etj

59. SHIRINGA 5 ML PLUS AGE 22 G



- Të jetë e përbërë nga 3 pjese
- Te jete e pajisur me agen
- Të jetë sterile dhe njëpërdorimshe, 5 cc
- Per aplikimin e medikamenteve sipas dozave dhe rruges se administrimit iv,im etj

60. SISTEM INFUZIONI



- Sisteme infuzioni
- Set i infuzionit venoz, transparent, fleksibël, pa latex, rezistent ndaj tërheqjes dhe kimikisht i qëndrueshëm
- Pajisje jo-invazive për administrimin intravenoz të barnave, tretësirave ose substancave të tjera.
- Karakteristikat: Rregullator i rrjedhës rul. Gjatësia e tubit: 150 cm.
- Lidhja: bllokues me vidhim ose mekanizëm femër mashkull.
- Produkt për përdorim profesional me shënimin CE

61. SONDË ASPIRIMI



- Aspiron likidet, legjet biologjike nga hapësira e gojës te personat me koshiencë të alteruar, me qëllim pengimin e aspirimit të tyre në rrugët e frymëmarrjes
- Me përmasa të ndryshme adulte dhe pediatrike, ne sasi te barabarte secila permase
- Me valvul për kontrollin manual të presionit të aspirimit.

62. SPIDER – RRIP SIGURIE ADULTE



- Sistemi universal i rripit merimangë për imobilizimin e shtyllës kurrizore
- Të mundësojë një fiksion të shpejtë të të dëmtuarit në barrelë, pa dëmtime të strukturave anatomike,
- Një imobilizim korrekt të kolonës dhe artikulacioneve, edhe në transporte të gjata e në kushtë të vështira,
- Rripat e ndërtuar nga material elastik dhe shumë i qëndrueshëm kanë në pjesën fundore të tyre ngjitëse që mundësojnë fiksionin e sigurt në barrelë dhe njëkohësisht mundësojnë shkëputjen e lehtë prej saj, në momentin e heqjes së spiderit.
- Eshte pjese e setit te imobilizimit te nje pascienti traumatik spinal .

63. STRISHA GLUKOMETRI

- Shiritat /strishot janë reaktive në sajë të elektrodës me sensorë, të përshtatshme me glukometrin.
- Fisha per matjen e nivelit te sheqerit ne gjak si nje nga parametrat jetesor per vleresimin e pacientit.

64. TERMOMETËR INFRA- RED TIMPANIK



- Matje e shpejtë e temperaturës së trupit.
- Termometër pa kontakt me trupin, i sigurt dhe higjenik.
- I përshtatshëm për të gjitha moshat,
- Fikje automatike.
- Regjiron matjet e fundit të temperaturës.
- Mat gjithashtu edhe temperaturën e ambientit.
- Shfaq temperaturën në njësi: °C.

65. RREGULLUES FLUKSI I.V



- Përdoret si rregullator i rrjedhës me precizion të lartë që përbën një zgjidhje praktike dhe të besueshme kur terapia kërkon një infuzion me një shpejtësi dhe kohë të caktuar.
Të përbëhet nga tre pjesë që garantojnë që tubat e hyrjes dhe daljes të jenë në një linjë pavarësisht nga pozicioni i numrit, duke siguruar saktësi maksimale të infuzionit.
- Të jetë i përshtatshëm për disa lloje infuzionesh dhe të siguroj një shpejtësi nga 5 deri në 250 ml/orë

66. TOURNIQUET URGJENCE



- Përdoret për ndalimin e hemoragjive të jashtme të gjymtyrëve kur nuk mund të kontrollohen me metoda të tjera. Vendoset në pjesën proksimale të gjymtyrëve të sipërm apo të poshtëm.
- Mbyllja me mekanizëm apo velkro në mënyrë që të sigurojë një shtrëngim të qëndrueshëm, me qëllim bllokimin e hemoragjisë.

67. TUBA (ET) ADULT



- Të mundësojë intubim të shpejtë dhe padëmtime të strukturave anatomike në sajë të një veshje mbuluese të butë dhe të rrëshqitshme
- Të jetë opake për lehtësi vizualizimi dhe në sipërfaqe të shënohen dukshëm diametri dhe gjatësia e tubit.
- Tubi endotrakeal me manshetë është bërë nga PVC jo toksike në shkallë mjekësore, përbëhet nga tubi, manshetë, linjë fryrjeje, valvul, balonë pilot dhe lidhës.
- Të jetë në 3 masa adulte, në sasi të barabartë secila masë.

68. IMOBILIZUES RIKUPERIMI TOTAL



- Imobilizues dhe transportues të pacientit traumatik në hapsira të kufizuara (të ngushta) terrene të vështira për tu aksesuar nga mjetet e urgjencës.
- Përbëhet nga material rezistent, doreza anësore, për transport, rripa sigurimi për bllokimin e pacientit.
- Set me litarë, gança, rripa për tërheqje dhe ngritje.
- Për rekuperimin e pacientëve në zonat alpine, shpella, guva, humnera, ujë e tjer.
- Material polietilen
Madhesia jo me pak se 240x850 cm
Kapaciteti mbajtës jo me pak se 180kg
Të ketë rripa najloni me cilësi të lartë dhe rezistente, pasi lidhen me një barelë shpëtimi, garantojnë ekuilibrin e barelës gjatë fazave të ngritjes, tërheqjes ose uljes.

- Pesha; jo me shume se 10 kg

Të përfshihen në set:

- Çanta për barelën, aksesorët dhe një për të mbajtur instrumentet e tjera.
- rripa për tërheqje dhe ngritje
- një sistem rripash për montimin e barelës dhe më pas palosjen

69. MUSHAMA TELO ME RRIPA MBAJTËS KRAH-QAFË DHE DOREZA PËR TRANSPORTIN E PACIENTIT JO TRAUMATIK



- Pajisje e destinuar për rikuperimin dhe lëvizjen e pacientëve pa traumë të shtyllës kurrizore, nga vendi i ndërhyrjes së parë deri te barela apo mjeti i urgjencës. Të mundësoj transport të pacientit jo vetëm në një pozicion shtrirë, por edhe në një pozicion ulur.
- Mund të përdoret nga dy persona në terrene të vështira si shkallë të ngushta ose më shumë persona kur janë në dispozicion ose kur pacientii është obez.
- Të përfshijë shufra alumini për të reduktuar palosjen dhe shpërndarjen e peshës gjatë transportit.
 - Të jetë e përbër nga maerial pvc dhe rripa nejloni
 - Kapacitet mbajtës jo më pak se 130 kg
 - Të përfshi 8-10 doreza ngritëse anësore
 - E paloshme dhe e përshatshme për pacietët adult.

70. RRIPI SHPËTIMI (BOA)



- Pajisje mjekësore për imobilizimin e qafës dhe kolonës cervikale në situata emergjente.

E përshtatshme për:

- Ekipet e Urgjencës mjekësore paraspitalore
- Evakuimin në ambiente të vështira ose të kufizuara (si në automjete pas aksidentit).
- Projektuar në përputhje me parimet e trajnimeve moderne për traumat (si ato të përdorura në kurse të tipit PHTLS).

Karakteristika dhe përfitime:

Strukturë modulare, me 3 pjesë:

Mbulesë antibakteriale, e lehtë për t'u pastruar.

Material mbushëse, me material të butë që mund të përdoret edhe si batanije termike.

Rrip mbajtës me doreza, për manovrim dhe evakuim të sigurt.

Pjesët janë të zëvendësueshme individualisht.

Termoplastik me rezistencë të lartë ndaj temperaturave të larta dhe të gjata në kohë.

Ofron qëndrueshmëri të lartë mekanike dhe rigiditet, me ndjeshmëri të ulët ndaj çarjeve.

Gjatësia: jo më pak se 300 cm

Pesha: jo më shumë se 2kg

Përdorim i lehtë dhe i shpejtë në kushte të vështira operacionale

Paketimi përfshin çantë mbrojtëse për ruajtje dhe transport të sigurt

71. BARRELË FUSHORE



Pajisje thelbësore për:

- Ekipet e shpëtimit dhe urgjencës mjekësore
- Transportin e të plagosurve në ambiente të vështira dhe të ngushta
- Spitale fushorë, menaxhim fatkeqësish dhe ngjarje massive
- E përshtatshme për përdorim të shpejtë në terren dhe për ruajtje në hapësira të kufizuara.

Karakteristika dhe përfitime

- Konstrukti i lehtë dhe rezistent, me trup prej aliazh alumini me rezistencë të lartë.
- Palosje në katër pika: si gjatësore, ashtu edhe anësore — për kursim maksimal të hapësirës.
- Pëlhurë e qëndrueshme dhe e lehtë për t'u pastruar, rezistente ndaj ujit dhe ndotjeve.
- Ripa fiksime për pacientin për siguri gjatë transportit

Specifikime Teknike

- Gjatësia:jo më pak se 180 cm
- Gjerësia : jo më pak se 50 cm
- Pesha:jo më shumë se 10 kg

72. IMOBILIZUES ME VAKUM



Përdorimi

I përshtatshëm për:

- Ekipet e Urgjencës mjekësore.
- Situata të traumës ku kërkohet imobilizim dhe transport i sigurt i pacientit.
- Lejon realizimin e ekzaminimeve me rreze X falë transparencës radiologjike.

Karakteristika kryesore:

- Strukturë ergonomike për përputhje më të mirë me trupin e pacientit.
- Doreza të shumta , të shpërndara për manovrim të lehtë dhe të sigurt nga personeli.
- Litar anësor i integruar dhe përforcuar që shërben për lidhjen e rripave të fiksimit të pacientit.
- Material jo-absorbues , e përshtatshme për pastrim të shpejtë dhe higjienik.
- Valvulë vakumi rezistente ndaj temperaturave të ulëta dhe të larta, me përshtatës për lidhje tubi.

Të përfshira në set(pompë për krijimin e vakumit dhe çantë për transport dhe ruajtje.)

Të dhëna teknike

- Gjatësia: jo më pak se 195 cm
- Gjerësia: jo më pak se 90 cm
- Pesha (pa përfshirë pompën): deri në 6 kg
- Kapacitet ngarkese: jo më pak se 120kg
- Numër dorezash:jo më pak se 6

73. VIDEOLARINGOSKOP NJËPËRDORIMËSH



Tipi: Laringoskop video fleksibël

Përdorimi: Menaxhimi i rrugëve të frymëmarrjes / intubim orotraheal

Sistemi i vizualizimit: Kamera e integruar me transmetim video në kohë reale

Maja distale: E rregullueshme (artikulim për orientim më të mirë gjatë procedurës)

Fleksibiliteti: Tub fleksibël për navigim më të lehtë në rrugët ajrore të vështira

Fusha e shikimit: E zgjeruar për vizualizim optimal të strukturave anatomike

Ndriçimi: Burim drite LED i integruar

Ekрани: I jashtëm ose i integruar (në varësi të modelit)

Materiali: Biokompatibël, i përshtatshëm për përdorim mjekësor

Sterilizimi: I ripërdorshëm ose me komponentë njëpërdorimësh (sipas konfigurimit)

Përdorimi klinik: Urgjencë, anestezi, kujdes intensiv, mjekësi paraspitalore

Dizajni: Ergonomik për manovrim të lehtë dhe kontroll të saktë

74. LIFEVAC (ZHBLLOKUES I RRUGËVE TË FRYMËMARRJES)



- Pajisje mekanike për pastrimin e rrugëve të frymëmarrjes nga obstrukcioni (anti-choking)
- Punon me presion negativ (vakum)
- Krijon thithje për të larguar trupin e huaj nga rrugët ajrore
- Nuk shtyn objektin më thellë (valvul njëdrejtimore)

Përbërja e kompletit Kit):

1 × Pajisje LifeVac

4 × Maska (madhësi të ndryshme)

Karakteristika teknike:

- Përdorim manual
- Portative dhe kompakte
- E ripërdorshme (me maska të zëvendësueshme)
- Valvul sigurie njëdrejtimore

Përdorimi

- Në raste mbytjeje (choking) me obstrukcion të plotë

Për fëmijë, të rritur dhe të moshuar

75. BOUGIE (ENDOTRACHEAL INTRODUCER) UDHËZUES PËR INTUBIM INDOTRAKEAL



Introducer për tub endotrakeal (Bougie – Eschmann) ose ekuivalent.

- Pajisje ndihmëse për intubim endotrakeal, e përdorur si guidë në vendosjen e tubit në rrugët ajrore, veçanërisht në raste të rrugëve të vështira

Specifikimet teknike:

- Madhësia: 15 Fr (adult)
- Gjatësia: 60–70 cm
- Diametri: rreth 5 mm
- Maja: e kënduar (Coudé) 35–40°
- Materiali: fleksibël
- Me shenja distance
- Guidim i sigurt i tubit endotrakeal
- Përdorim në intubim të vështirë, CPR dhe shkëmbim tubi
- Njëpërdorimësh (preferohet)
- Pa lateks

Fotot janë demonstruese dhe ilustruese.

Njësia e prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurim për hedhjen e të dhënave në SPE.

NJËSIA E PROKURIMIT